**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AKADEMIA E SHKENCAVE**
**KRYESIA**

Prot 264

**Tiranë, 26 shkurt 2024**

## Vendim nr. 22 datë 26.02.2024
## Për funksionimin e redaksisë së revistës *Albanian Studies*

**Referuar nenit 4 pika 8 të Ligjit nr. 53/2029 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;**

**Në vijim të nismave të ndërmarra në zbatim të VKM nr. 821 datë 28.12.2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë*;**

**Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës __.__.2024,**

**Vendosi:**

**1. Revista *Albanian Studies*, e themeluar si tribunë shkencore e Akademisë së Studimeve Albanologjike, të vazhdojë botimin e rregullt me të njëjtin periodicitet, si revistë shkencore albanologjike e Akademisë së Shkencave.**

**2. Kryeredaktor i *Albanian Studies* të jetë akad. Marenglen Verli. Këshilli botues (*publishing board*) dhe redaksia (*editorial board*) përkohësisht të jenë ato të tanishmet, ndërsa sekretar shkencor të jetë prof. asoc. dr. Gjon Boriçi.**

**3. *Albanian Studies* të promovojë në gjuhën angleze kryesisht artikujt më cilësorë të revistave albanologjike: *Iliria*, *Studime filologjike*, *Studime historike*, *Antropologji* dhe *Studime për artin*; si dhe të botimeve të ngjashme me to.**

**4. Deri në riorganizimin e këshillave botues dhe të redaksive shkencore përbërja e tyre të jetë si deri sot. Stabilizimi i këshillave botues dhe redaksive shkencore të reja të bëhet pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në rregulloren e periodikëve shkencorë.**

**5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryeredaktorët/drejtorët e instituteve të albanologjisë dhe sekretari shkencor.**

**6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Akad. Skënder GJINUSHI**
**KRYETAR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE